

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6118
E shtunë, 19 shtator 2020
çmimi 0.40 €

Quinti bën thirrje
që të kundërshtohet çdo
përpjekje për ta zhvlerësuar
Gjykatën Speciale FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI, NDERON PRESIDENTIN E SHBA-SË, DONALD TRUMP, ME URDHRIN MË TË LARTË SHTETËROR DHE E FTON TA VIZITOJË KOSOVËN

THAÇI I NDAN 'URDHRIN E LIRISË' PRESIDENTIT TRUMP

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka ndarë presidentit të ShBA-së, Donald Trump, "Urdhrin e Lirisë", në shenjë mirënjohjeje për kontributin e ShBA-së dhënë për lirinë e Kosovës, për forcimin e paqes dhe të stabilitetit në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në një letër që i ka dërguar presidentit Trump, Thaçi e ka falënderuar liderin amerikan për arritjen e marrëveshjes për normalizim ekonomik në mes të Kosovës dhe Serbisë. Gjithashtu, me "Medaljen Presidenciale të Meritave" Thaçi ka nderuar edhe këshilltarin e Trumpit për siguri kombëtare, Robert O'Brien dhe të dërguarin special, ambasadorin Richard Grenell. FAQE 3



PRESIDENCA DHE QEVERIA, TË PAKOORDINUARA PËR DIALOGUN ME SERBINË

Presidenca dhe Qeveria nuk janë duke bashkëpunuar në procesin e dialogut në Bruksel, në të cilin po diskutohet për draftimin e marrëveshjes finale në mes të Kosovës dhe Serbisë. Mungesën e këtij bashkëpunimi e kanë konfirmuar edhe zyrtarët e këtyre institucioneve. Së fundi Presidenca e Kosovës ka shprehur shqetësimin për mundësinë e hapjes së temave në dialogun e Brukselit për të drejtat e komuniteteve dhe për asociacionin e komunave me shumicë serbe. Presidenca i ka kërkuar Kuvendit që urgjentisht me rezolutë t'ia ndalojë këtë qeverisë FAQE 4-5



GAZETARJA ALBULENA MAVRAJ FITON ÇMIMIN E PARË PËR GAZETARI NË SEKTORIN E EKONOMISË

FAQE 3

AKTUALE



**META: MANDATIN E PRESIDENTIT
DO TA LIJA VETËM PËR
ZGJIDHJEN E KRIZAVE** F. 2

**MBI 30 MILIONË TË INFEKTUAR
NGA KORONAVIRUSI NË BOTË** F. 7

**LUSHTAKU: DIALOGU DHE
ZHVILLIMET ME SPECIALEN
KANË NEVOJË PËR QEVERI TË
QËNDRUESHME** F. 7

EKONOMI



**PRODHUESIT VENDORË
KËRKOJNË FAVORIZIME NË
PROCEDURAT TENDERUESE** F. 9

**ASK-ja: BRUTO PRODUKTI
VENDOR NË VITIN 2019
SHËNOI RRIJTJE** F. 9

KULTURË

**DUMOSHI I INKURAJON
TË RINJTË TË MËSOJNË
MË SHUMË PËR TRASHËGIMINË
E KOSOVËS** F. 6

SPORT

**NDARJE EMOCIONUESE
E MUSOLLIT ME KUKËSIN,
E ARDHMJA ËSHTË GJILANI** F. 14

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Meta: Mandatin e presidentit do ta lija vetëm për zgjidhjen e krizave



TIRANË, 18 SHTATOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka shprehur edhe një herë gatishmërinë për ta lënë mandatin e tij si president, nëse ky akt i shërben zgjidhjes së krizave. “Prej kohësh kam qenë i gatshëm për hir të marrëveshjeve të cilat zgjidhin krizën e

legjitimitetit dhe institucioneve kryesore të vendit ta lija edhe postin e presidentit vetëm te gjendet një zgjidhje afatgjatë për vendin, pa pasur parasysh as interesat e mia personale dhe as karrierën time. Por dua t’ju siguroj pa hyrë në përpjekje dhe komente që kërkojnë ta

tërheqin vëmendjen nga çështjet e mëdha që ka vendi, nga garantimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme më 25 prill”, ka thënë Meta. Por presidenti tha se do të jetë në zyrën e tij deri më 24 korrik 2022. “Në të gjitha rastet premtimin që kam bërë, ky institucion deri më

24 korrik 2022 do të jetë kështjellë e pamposhtur në mbrojtje të Kushtetutës, lirisë dhe demokracisë dhe të ardhmes evropiane të vendit, këtë do ta mbroj në të gjitha mënyrat. Për këtë duhet të jemi të qetë, për këtë institucion, deri më 24 korrik 2022”, ka thënë presidenti Meta.

Cakaj: Kontributi i faktorit shqiptar në Maqedoninë e Veriut mbetet i patjetërsueshëm

SHKUP, 18 SHTATOR (ER) - Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Gent Cakaj, ka takuar të premten në Shkup edhe kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev. Ai ka bërë me dije se me Zaevin kanë folur për mbajtjen e mbledhjes së përbashkët ndërqeveritare dhe rëndësinë e punës së përbashkët për përparimin e mëtejshëm në rrugën e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. “Lidhur me zhvillimet në rajon, mes të tjerash, theksova se e vetmja zgjidhje e qëndrueshme në

procesin e bisedimeve në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë është ajo që përfshin njohjen e ndërsjellë. Ndërkohë, një lajm tjetër i mirë nga kjo vizitë: Maqedonia e Veriut do ta mbështesë Shqipërinë për t’u bërë anëtare e Këshillit të Sigurimit 2022-2023”, ka shkruar Cakaj në llogarinë e vet në “Facebook”. Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Gent Cakaj, gjatë qëndrimit zyrtar në Shkup ka zhvilluar edhe disa takime me krerët e partive shqiptare në Maqedoninë e Veriut. “Së



bashku me kryetarin e Aleancës për Shqiptarët, z. Ziadin Sela, kryetarin e Lëvizjes Besa, z. Bilal Kasami, kryetarin e

Partisë Demokratike Shqiptare, z. Menduh Thaçi, si dhe kryetarin e Alternativës, z. Afrim Gashi, vlerësuam rolin e

pazëvendësueshëm në zhvillimin e demokracisë së brendshme, procesin e anëtarësimit në NATO dhe rrugëtimin e Maqedonisë së Veriut drejt Bashkimit Evropian”, ka shkruar Cakaj në llogarinë e vet në “Facebook”.

Ai ka theksuar se përtej dallimeve politike, kontributi i faktorit shqiptar në Maqedoninë e Veriut për mbrojtjen e interesave kombëtare, zhvillimin e përgjithshëm institucional dhe ruajtjen e drejtimit euroatlantik të vendit, mbetet i patjetërsueshëm.

ShBA-ja do ta ndalojë shkarkimin e aplikacioneve TikTok dhe WeChat

NJU-JORK, 18 SHTATOR - Platformat sociale TikTok dhe WeChat do të ndalohen në tregjet amerikane të aplikacioneve nga dita e diel, përveç nëse presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, pajtohet për ndonjë marrëveshje në minutën e fundit.

Departamenti amerikan i Tregtisë ka thënë se vendimi do t’ua ndalojë banorëve në ShBA shkarkimin e këtyre aplikacioneve. “Me udhëzim të presidentit, ne kemi marrë vendim për ta luftuar koleksionimin e dëmshëm të të



dhënave personale të qytetarëve kinezë nga ana e Kinës”, ka thënë sekretari i

Departamentit të Tregtisë, Wilbur Ross. Administrata Trump ka thënë

se këto kompani kërcënojnë sigurinë kombëtare dhe përmes tyre të dhënat mund të kalojnë tek autoritetet kineze. Mirëpo Kina dhe të dyja këto kompani mohojnë këto pretendime.

WeChat do të ndalohet në ShBA të dielën, mirëpo njerëzit do të mund ta përdorin aplikacionin TikTok deri më 12 nëntor, kur do të mund të ndalohet plotësisht kjo platformë.

Nëse partneriteti i planifikuar në mes të kompanisë Oracle dhe kompanisë ByteDance, që drejton TikTok-un, zyrtarizohet

dhe miratohet nga presidenti Trump, atëherë aplikacioni nuk do të ndalohet.

Ende nuk është bërë e qartë nëse Trumpi do ta miratojë marrëveshjen, mirëpo pritet që ta rishikojë atë para afatit të fundit të së dielës.

TikTok ka thënë se ka 100 milionë përdorues amerikanë dhe 700 milionë në gjithë globin.

Ky aplikacion ofron mundësi të realizimit të videove të shkurtra argëtuese të njerëzve duke vallëzuar, duke imituar të tjerët apo duke sfiduar njëri-tjetrin në gara të ndryshme.

Mbi 30 milionë të infektuar nga koronavirusi në botë

NJU JORK, 18 SHTATOR - Mbi 30 milionë njerëz janë infektuar me koronavirus në nivel global, ka njoftuar Universiteti “Johns Hopkins” me seli në Shtetet e Bashkuara.

Më shumë se 940 000 kanë vdekur nga sëmundja Covid-19 që nga fillimi i shpërthimit të pandemisë në Kinë, në fund të vitit të kaluar.

Vendet më të goditura janë ShBA-ja, India dhe Brazili, por

ka një rritje të numrit të të infektuarve në të gjithë Evropën.

Shumë vende tani po përgatiten për një valë të dytë të pandemisë, ndërsa dimri po afrohet.

Në Mbretërinë e Bashkuar qeveria po konsideron marrjen e masave të mëtejshme në të gjithë Anglinë, duke përfshirë një periudhë të shkurtër izolimi, në përpjekje për ta ngadalësuar

përhapjen e virusit.

Jashtë Evropës, Izraeli ka vendosur një bllokim të dytë mbarëkombëtar, vendi i parë i zhvilluar që e bën këtë.

Afrika ka regjistruar më shumë se një milion raste të konfirmuara, megjithëse nuk dihen përmasat e vërteta të pandemisë në këtë kontinent. Shkalla e testimit raportohet të jetë e ulët, gjë që mund t’i shtrembërojë shifrat zyrtare.



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, nderon presidentin e ShBA-së, Donald Trump, me urdhrin më të lartë shtetëror dhe e fton ta vizitojë Kosovën

Thaçi i ndan 'Urdhrin e Lirisë' presidentit Trump



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka ndarë presidentit të ShBA-së, Donald Trump, "Urdhrin e Lirisë", në shenjë mirënjohjeje për kontributin e ShBA-së për lirinë e Kosovës, për forcimin e paqes dhe të stabilitetit në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në një letër që i ka dërguar presidentit Trump, Thaçi e ka falënderuar liderin amerikan për arritjen e marrëveshjes për normalizim ekonomik në mes të Kosovës dhe Serbisë. Gjithashtu, me "Medaljen Presidenciale të Meritave" Thaçi ka nderuar edhe këshilltarin e Trumpit për siguri kombëtare, Robert O'Brien dhe të dërguarin special, ambasadorin Richard Grenell

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka ndarë urdhrin më të lartë shtetëror - "Urdhrin e Lirisë" - për presidentin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, në shenjë mirënjohjeje për

kontributin e tij për lirinë e Kosovës, për forcimin e paqes dhe stabilitetin në rajon. Po ashtu, presidenti Thaçi ka ftuar presidentin Trump që ta vizitojë Kosovën në të ardhmen e afërt.

I pari i shtetit, në letër drejtuar presidentit Trump, ka deklaruar se marrëveshja për normalizimin ekonomik në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk do të ishte e mundur pa udhëheqjen e fuqishme të tij dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. "I dashur z. President, dëshiroj ta shpreh mirënjohjen time të thellë për kontributin tuaj personal në arritjen e marrëveshjes për normalizimin ekonomik në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kjo marrëveshje është përparim i rëndësishëm së jashtëzakonshme për përmbylljen e konfliktit shekullor mes popujve tanë. Pas dekadash bllokade dhe stagnimi në negociatë, falë udhëheqjes tuaj të guximshme e arritëm këtë marrëveshje historike. Populli i Kosovës mbetet përjetësisht mirënjohës ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës - shpëtimtares sonë që në ditët tona më të errëta na qëndroi pranë dhe vazhdon edhe sot", ka shkruar Thaçi në letër drejtuar presidentit Trump.

Ai ka pohuar se Kosova mbetet e përkushtuar ndaj paqes së qëndrueshme dhe prosperitetit afatgjatë në Ballkanin Perëndimor. "Kemi punuar shumë në këto vite dhe jemi të përgatitur ta japim kontributin tonë për paqe dhe siguri në botë. Po ashtu, jemi të palëkundur në përkushtimin tonë për arritjen e një marrëveshjeje që zgjidhë të gjitha çështjet e hapura dhe sjell njohjen e ndërsjellët në mes të Kosovës dhe Serbisë. Është më e

qartë se kurrë, që kjo mund të arrihet vetëm nën udhëheqjen e fuqishme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Roli juaj në këtë proces është jetik. Kosova është me të vërtetë e bekuar që

gëzon mbështetjen tuaj të palëkundshme për përmbushjen e aspiratave të saj. Z. President, kam privilegjin, si President i Republikës së Kosovës, që në shenjë mirënjohjeje për

kontributin tuaj personal për lirinë e Kosovës, në arritjen e paqes, pajtimit dhe prosperitetit ekonomik, të ndaj për ju Urdhrin e Lirisë", ka shkruar Thaçi.

Presidenti Thaçi ka thënë se marrëveshja e nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë nuk do të kishte qenë e mundur pa energjinë, synimin e qartë, dhe angazhimin direkt, të palëkundur dhe besnik të këshilltarit të Trumpit për siguri kombëtare, Robert O'Brien dhe të dërguarit special, ambasadorit Richard Grenell. "Në shenjë mirënjohjeje për përpjekjet e tyre, po ashtu kam ndarë 'Medaljen Presidenciale të Meritave' për z. O'Brien dhe z. Grenell, për meritat e tyre të veçanta në arritjen e marrëveshjes historike mes Kosovës dhe Serbisë, të nënshkruar në Uashington. Në emër të popullit të Kosovës kam kënaqësinë t'ju ftoj që ta vizitoni Kosovën dhe të bindeni për progresin që ju e keni bërë të mundur. Do të ishte nder i madh t'ju mirëpres dhe t'ju prezantoj popullin më pro-amerikan në botë", ka shkruar Thaçi në fund të letërës së tij drejtuar presidentit të ShBA-së.

Gazetarja Albulena Mavraj fiton çmimin e parë për gazetari në sektorin e ekonomisë

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Instituti Riinvest, në bashkëpunim me Bashkimin Evropian, BIRN-in dhe AGK-në, në kuadër të projektit "Kontributi për forcimin e gazetarisë së pavarur, hulumtuese dhe të dobishme për publikun, si dhe për lirinë e shprehjes në Kosovë", financuar nga BE-ja dhe zbatuar nga BIRN dhe AGK, pas trajnimit gjashtëmujor të gazetarëve të sektorit të ekonomisë në Kosovë, ka shpallur fituesit e tri çmimeve të para. Çmimin e parë në këtë garë e ka fituar gazetarja e sektorit të ekonomisë në gazetën "Epoka e re", Albulena Mavraj, çmimin e dytë e ka fituar Albiona Hajdari, kurse çmimin e tretë Lulzim Ahmeti.





INSTITUCIONET E KOSOVËS, TË PAKOORDINUARA NË PROCESIN E DIALOGUT KOSOVË - SERBI

PRESIDENCA DHE QEVERIA, TË PAKOORDINUARA PËR DIALOGUN ME SERBINË

Presidenca dhe Qeveria nuk janë duke bashkëpunuar në procesin e dialogut në Bruksel, ku po diskutohen për draftimin e marrëveshjes finale në mes të Kosovës dhe Serbisë. Mungesën e këtij bashkëpunimi e kanë konfirmuar edhe zyrtarët e këtyre institucioneve. Së fundi Presidenca e Kosovës ka shprehur shqetësimin për mundësinë e hapjes së temave për të drejtat e komuniteteve dhe për asociacionin e komunave me shumicë serbe në dialogun e Brukselit. Presidenca i ka kërkuar urgjentisht Kuvendit që t'ia ndalojë këtë qeverisë me rezolutë

krijohet një entitet politik, i cili do të ishte riprodhim i Republikës Serbe në territorin e Kosovës”, është thënë në deklaratën për medie të Presidencës.

Aty është vlerësuar se diskutimi për asociacion është fillim i instalimit të Republikës serbe në Kosovë. “Diskutimi për asociacionin nesër në Bruksel është fillim i instalimit të Republikës serbe brenda Republikës së Kosovës, ndërsa diskutimi për pronat e Kosovës me Serbinë është në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, si dhe është cenim i sovranitetit të shtetit tonë”, ka thënë Thaçi, duke e ftuar urgjentisht Kuvendin e Kosovës ta votojë një rezolutë, me të cilën kryeministrit i ndalohet të negociojë për çështje të brendshme. “Kuvendi i Kosovës urgjentisht duhet ta trajtojë këtë hap të rrezikshëm të Qeverisë së Kosovës në dialogun e Brukselit. Po ashtu, urgjentisht

duhet ta votojë edhe një rezolutë, me të cilën kryeministrit i ndalohet të negociojë për çështje të brendshme të Kosovës dhe për tema që rrezikojnë rendin e brendshëm shtetëror”, është thënë në deklaratë.

Mirëpo kryeministri i Kosovës i ka mohuar pretendimet e Presidencës.

Gjatë raportimit në Kuvend para deputetëve, një ditë më parë, shefi i qeverisë ka treguar se në takimin e 7 shtatorit me presidentin serb në Bruksel është hapur tema e obligimeve financiare dhe tema e asociacionit të komunave me shumicë serbe. Sipas tij, qëndrimi i Kosovës është se nuk do të diskutohet për asociacionin në Bruksel. “Ndërkaq lidhur me temën e asociacionit, qëndrimi ynë është se kjo temë nuk hapet në dialog, pasi ka një marrëveshje të arritur për këtë më 2013, që është ratifikuar në Kuvendin e

e Kosovës ka shprehur shqetësimin se hapja e temave për të drejtat e komuniteteve dhe për asociacionin e komunave me shumicë serbe në dialogun e Brukselit është gabim shumë i rrezikshëm i Qeverisë së Kosovës.

Një gjë e tillë, sipas presidencës, është goditje ndaj shtetësisë dhe cenim i sovranitetit të shtetit. “Hapja e temave për të drejtat e komuniteteve dhe për asociacionin e komunave serbe në dialogun e Brukselit është gabim i madh dhe shumë i rrezikshëm i Qeverisë së

Kosovës. Është goditje ndaj shtetësisë dhe cenim i sovranitetit të shtetit tonë. Këto tema janë adresuar dhe zgjidhur në kuadër të Pakos së Ahtisaarit, e cila i parapriu shpalljes së pavarësisë, por edhe në kuadër të Marrëveshjes së Brukselit në prill të vitit 2013 dhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, askush nuk ka mandat që të bisedojë në emër të Kosovës për tema të mbyllura, në Bruksel apo kudo qoftë. Kosova nuk mund dhe me asnjë çmim asnjëherë nuk do të lejojë që brenda territorit të saj të

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Presidenca dhe Qeveria nuk kanë koordinim për procesin e dialogut për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë i cili po zhvillohet në Bruksel. Këto dy institucione së fundi kanë shfaqur hapur mospajtimet që kanë për këtë proces. Madje zyrtarët e këtyre institucioneve kanë konfirmuar mungesën e bashkëpunimit të Presidencës dhe Qeverisë për këtë proces. Përmes një deklaratë për media, Presidenca



Kuvendi nuk miraton rezolutën për dialogun

As në këtë legjislaturë nuk është arritur të nderohet një konsensus nacional për dialogun me Serbinë. Pozita dhe opozita qëndrimet e ndryshme për këtë proces i kanë konfirmuar në seancën e së enjtes në Kuvend, ku ka raportuar kryeministri për marrëveshjen e Uashingtonit dhe takimin e 7 shtatorit në Bruksel.

Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës kanë kritikuar kryeministrin Avdullah Hoti për lëshimet e bëra në marrëveshjen me Serbinë të arritur në Uashington. Deputetët e LV-së kanë vlerësuar se me këtë marrëveshje ka fituar Serbia dhe jo Kosova. "Kosova nuk del me fitore nga nënshkrimi juaj, zotëri Hoti. Nga ai nënshkrim më së shumti kanë përfituar të tjerët. Në këtë rast, përfituesja më e madhe del Serbia sepse përfitoi dalje në Adriatik,

bashkëpronësi në Ujman, zhbërje të kufirit shtetëror, pra nga kufij shtetërorë në pikë të kalimit të përbashkët, realizimin e idesë për mini-Shengen që, në fakt, është zonë e Novi Sadit", ka deklaruar Rexhep Selimi, shef i grupit parlamentar i LV-së.

Kurse deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka deklaruar se delegacioni i Kosovës nuk ka negociuar fare për marrëveshjen në Uashington. Hoxhaj ka thënë se ajo që është arritur në Shtëpinë e Bardhë është meritë e amerikanëve dhe jo e delegacionit të Kosovës. Në fund të debatit, LV-ja ka propozuar një rezolutë për procesin e dialogut, në të cilën thuhet se kryeministri Hoti nuk është autorizuar nga Kuvendi për bisedimet me Serbinë në Bruksel, por e cila as të premtën nuk është votuar në Kuvend në mungesë të kurimit.

asgjë nuk nënshkruhet derisa të dakordohet marrëveshja e plotë, përfundimtare, ligjërishit e obligueshme, që përfshinë njohjen reciproke. Marrëveshja përfundimtare do të jetë marrëveshje e parimeve për normalizim të marrëdhënieve në mes të dy vendeve pas njohjes reciproke. Kjo marrëveshje nuk do të ofrojë zgjidhje kreative të çështjeve të hapura në mes të vendeve. Por, do të ofrojë zgjidhje sistematike, bazuar në konventat ndërkombëtare. Marrëveshja nuk do të ofrojë zgjidhje të përkohshme apo

afatgjatë, por zgjidhje të përhershme. Ndryshe nuk do të ketë marrëveshje", ka deklaruar Hoti.

Moskoordinimin e këtyre dy institucioneve e ka konfirmuar edhe këshilltari i presidentit Hashim Thaçi, Adil Behramaj. Sipas tij, nuk ka bashkëpunim mes kryeministrit dhe presidentit, e as bashkëpunim qeveri-opozitë lidhur me dialogun apo marrëveshjen e re. "Në fakt, kryeministri dhe klubi i valltarëve të tij janë kah e bëjnë situatën shumë shqetësuese. Nuk ka unitet brenda qeverisë.

Nuk ka kurrfarë bashkëpunimi mes kryeministrit dhe presidentit. Nuk ka kurrfarë bashkëpunimi në mes të qeverisë dhe opozitës", ka shkruar Behramaj në profilin e vet në "Facebook".

Ai ia ka kujtuar qeverisë se nuk i ka në përbërje as 40 deputetë shqiptarë. "Mungesa e kohezionit të brendshëm, ku 40 vota shqiptare nuk dihet nëse i ka kjo qeveri dhe fati i çdo vendimi të saj varet

ekskluzivisht nga Lista Serbe. Për çdokënd që i kupton pak këto procese do të duhej të ishte shumë shqetësuese. Po ashtu, mungesa absolute e përkrahjes opozitare, sipas së cilës, kryeministri me 25 mijë vota dhe qeveria e tij nuk kanë fare legjitimitet të na përfaqësojnë, se lëre më edhe të nënshkruajnë marrëveshje të rëndësishme për fatin e Kosovës, sërish do të duhej të ishte shqetësuese", ka shkruar ai.

Asociacioni me kompetenca ekzekutive dëmton funksionalitetin e shtetit

Ish-ambasadori i Kosovës në Austri, Sabri Kiçmari, ka bërë me dije se njohja e ndërsjellë është një imperativ kategorik për marrëdhënie të mira ndërfqinjësore. Në një intervistë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se diplomacia e Kosovës ka dështuar që t'ia paraqesë botës të drejtat dhe privilegjet që ia ka dhënë pakicës serbe. "Vuçiqi operon me një sintagmë tregtari në lidhje me raportet Kosovë - Serbi: 'Kosova nuk mund t'i fitojë të gjitha dhe Serbia të mos fitojë asgjë'. Diplomacia jonë nuk ka qenë në gjendje t'i transmetojë në publikun ndërkombëtar fitoret e madhe që kanë realizuar serbët e Kosovës: garantimin e dhjetë vendeve në parlament, garantimin e përfaqësuesve

serbë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, krijimin artificialisht të komunave me shumicë etnike serbe, gjuhën serbe si gjuhë zyrtare dhe të drejta të nivelit të lartë për pakicën serbe. Kosova duhet t'i shfrytëzojë më mirë këto elemente", ka thënë Kiçmari. Sipas tij, një asociacion me kompetenca ekzekutive do ta dëmtonte funksionalitetin e shtetit të Kosovës. "Njohja e ndërsjellë është një imperativ kategorik për marrëdhënie të mira ndërfqinjësore. Por, një asociacion me kompetenca ekzekutive do ta dëmtonte funksionalitetin e Republikës. Gjykata Kushtetuese e ka dhënë mendimin e vet në lidhje me këtë. Delegacioni i Kosovës nuk do të duhej të hyjë në negociata antikushtetuese", është shprehur ai.

Kosovës. Përtej kësaj ekziston marrëveshja e parimeve për asociacionin dhe aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë çështje", ka thënë Hoti.

Ai ka bërë me dije se për të gjitha temat që diskutohen në Bruksel vlen parimi se "asgjë nuk dakordohemi derisa nuk dakordohemi për të gjitha". "Pra,

Quinti bën thirrje që të kundërshtohet çdo përpjekje për ta zhvlerësuar Gjykatën Speciale

Prishtinë, 18 shtator - Ambasada e Francës, Gjermanisë, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe e Shteteve të Bashkuara të Amerikës i kanë bërë thirrje Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës që të kundërshtojnë çdo përpjekje për të prishur ose zhvlerësuar misionin e Dhomave të Specializuara të Kosovës (DhSK) dhe të Zyrës së Prokurorisë së Dhomave të Specializuara (ZPDhS), si dhe që të sigurojnë që ato ta kryejnë misionin e tyre në përputhje me Kushtetutën. Përmes një komunikate për media, vendet e Quintit kanë përgëzuar edhe vendimin e kryetares së Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, për të kërkuar nga Gjykata Speciale që ta shqyrtojë kërkesën e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, për bërjen e ndryshimeve kushtetuese që lidhen me mandatin e kësaj Gjykate. "Në këtë vazhdë e përgëzojmë kryetaren e Kuvendit të Kosovës që e ka përcjellë propozimin e presidentit për

ndryshim të Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese në Hagë, si dhe Zyrën e Prokurorit Special të Republikës së Kosovës për respektimin e autoritetit të ZPDhS-së për ta hetuar zbulimin e mundshëm të paligjshëm të dokumenteve dhe informatave të besueshme, njëkohësisht duke ofruar ndihmën e saj sipas nevojës", thuhet në deklaratën e përbashkët të shefave të misioneve të Francës, Gjermanisë, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në këtë letër, që ka siguruar "Radio Evropa e Lirë", Osmani ka kërkuar shqyrtim paraprak se ndryshimet e propozuara nuk zvogëlojnë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës mbi të drejtat dhe liritë themelore. Sipas nenit 144 të Kushtetutës, ndryshimet kushtetuese miratohen me 2/3 e votave të deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Votimi bëhet pasi që kryetarja e Kuvendit t'i adresohet



Kushtetueses për t'i vlerësuar paraprakisht ndryshimet e propozuara. Dhomat e Specializuara kanë

thënë për "Radion Evropa e Lirë" se presidentja e Gjykatës Speciale, Ekaterina Trendafilova, do t'ua dorëzojë gjyqtarëve të Dhomave

të Specializuara të Gjykatës Kushtetuese kërkesën e nisur nga kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, rreth ndryshimeve kushtetuese që lidhen me mandatin e kësaj gjykate.

Më 25 gusht presidenti Thaçi i është drejtuar kryesisë së Kuvendit të Kosovës me propozim për amendamentimin e Kushtetutës për zgjatjen e mandatit të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar në Hagë.

Thaçi në propozimin e tij dërguar kryesisë së Kuvendit ka kërkuar të ndryshohet neni i amendamentit, ku thuhet se mandati i këtij institucioni do të zgjasë për një periudhë pesëvjeçare. Sipas propozimit të Thaçit, mandati i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar "do të zgjasë deri kur njoftimi i përfundimit të mandatit të bëhet nga Këshilli i Bashkimit Evropian, në konsultim me Qeverinë e Republikës së Kosovës".

Dumoshi i inkurajon të rinjtë të mësojnë më shumë për trashëgiminë e Kosovës

PRISHTINË, 18 SHTATOR (ER) - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka pritur të premtën në takim një grup të rinjsh nga komunitete të ndryshme të Kosovës. Ministrja Dumoshi gjatë këtij takimi tha se është kënaqësi kur organizatat rinore kërkojnë takime për t'i shprehur idetë dhe kërkesat e tyre sepse kjo ua mundëson asaj dhe ministrisë t'i realizojnë politikat rinore. "Në këtë kohë pandemie keni bërë një punë të shkëlqyer përmes aktiviteteve të ndryshme. Duke pasur parasysh që ne si ministri e kemi prioritetin rinor ju jeni të mirëseardhur çdoherë për t'i shprehur idetë dhe kërkesat e juaja. Përmes projekteve kemi

paraparë t'i certifikojmë 400 të rinj si ndërmarrës", ka deklaruar ministrja Dumoshi, duke shtuar se kanë paraparë që 400 të rinj t'i certifikojnë si ndërmarrës të rinj. "Kjo rrjedhimisht reflekton në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Për mua ka qenë kënaqësi që në Ranilluk u dhanë certifikimet e para për të rinjtë e komitetit serb dhe kjo do të vazhdohet edhe më tutje me certifikimet që do t'u bëhen të rinjve të etnive të ndryshme", u shpreh ministrja Dumoshi. Ndërkaq Egzona Shala, drejtoreshë e EKOS-it, falënderoi ministrin Dumoshi për përkrahjen në emër të të rinjve pjesëmarrës. "Këta të rinj kanë shprehur vullnetin të



vijnë e të krijojnë një komunikim të ndërsjellë me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit", ka thënë ajo. Pas këtij takimi ministrja së bashku me të rinjtë vizituan Muzeun e Kosovës ku u pritën nga drejtori

i muzeut, Ajet Leci. Ministrja Dumoshi u tha të rinjve se ky është një rast i mirë që të njoftohen me Muzeun e Kosovës, duke inkurajuar të rinjtë që të mësojnë më shumë për trashëgiminë e Kosovës. Ajo

ka theksuar se është shumë e nevojshme që të rinjtë e Kosovës të mësojnë më shumë për trashëgiminë tonë kulturore dhe për historinë e përbashkët të vendit të cilit i përkasin.

Shukri Buja dënohet me dy vjet burgim



PRISHTINË, 18 SHTATOR - Me dy vjet burgim është dënuar ish-kryetari i Lipjanit, Shukri Buja, dënim ky që do të ekzekutohet 15 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij aktgjykimi. Buja akuzohej për rastin e njohur si "Feronikeli", bashkë me tetë persona të tjerë, për marrje rryshfeti dhe ushtrim ndikimi. Më 2018 ishte dënuar me tre vjet burgim, por rasti i ishte kthyer në rigjykim. Seanca gjyqësore finale ndaj tij ishte paraparë të mbahej më 9 shtator, por Buja ishte vetizoluar për shkak të simptomave të koronavirusit. Gjykata Themelore në Prishtinë ka refuzuar akuzat ndaj Bujës për pikat

"keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe ushtrim të ndikimit". Buja është obliguar, po ashtu, që brenda 15-ditësh t'ia kompensojë Komunës së Lipjanit rreth 79 mijë euro në formë kompensimi për dëmin që ia ka shkaktuar. Avokati i tij, Arianit Koci, në një deklaratë për media ka thënë se nuk janë përfillur rekomandimet e Gjykatës së Apelit dhe se nuk i është dhënë koha e duhur që ta përgatisë çështjen e këtij rasti. Siç theksoi ai, tash janë në pritje të arsyetimit të Gjykatës për aktgjykimin e marrë edhe pse, siç u shpreh ai, nuk beson se do ta kenë të lehtë arsyetimin. "Tash do të shoh se si do ta bëjë

arsyetimin gjykata dhe besoj se nuk do ta ketë punë të lehtë ta arsyetojë këtë vendim. Gjykata e Apelit së pari ka kërkuar të nxjerrin prova që të vërtetohet fajësia e Bujës, dhe prova në drejtim të vërtetimit të dashjes nëse vërtetohet fajësia, këto nuk janë përfillur. E keni parë që rigjykimi ka përfunduar brenda dite dhe menjëherë të nesërmen është caktuar fjala përfundimtare dhe sot është shpallur aktgjykimi. Kjo është një prej gjykimeve më të shpejta prej që unë punoj si avokat", ka thënë ai. Koci ka theksuar se gjykatësi do të duhej t'i lejonte që t'i paraqesin provat e reja, por një gjë e tillë është refuzuar.

Bajrami në Uashington bisedon me Bankën Botërore për thellimin e bashkëpunimit me Kosovën

WASHINGTON, 18 SHTATOR (ER) - Në kuadër të vizitës zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka zhvilluar takim me delegacionin e Bankës Botërore të udhëhequr nga Anna Bjerde, zëvendës-presidente e Bankës Botërore për Evropë dhe Azi Qendrore. Temë e diskutimit ishte fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore në projekte që kanë për objekt zhvillimin ekonomik të Kosovës. Në takim u diskutua portofoli ekzistues i projekteve, përshpejtimi i implementimit të projekteve, hapësira fiskale për projekte të reja, si dhe instrumenti për

zhvillimin e politikave si një platformë e rëndësishme e bashkëpunimit ndërmjet Bankës Botërore dhe Kosovës. Ministrja Bajrami e informoi ekipin e Bankës Botërore lidhur me kontekstin socio-ekonomik në vendin tonë dhe implikimet e shkaktuara nga pandemia Covid-19 në ekonominë e Kosovës. Ajo nënvizoi se Qeveria e Kosovës po punon intensivisht për adresimin e sfidave socio-ekonomike të shkaktuara nga pandemia dhe në këtë kuadër e mirëpret gatishmërinë e Bankës Botërore për të punuar ngushtë me Qeverinë e Kosovës për shtimin e bashkëpunimit i cili do të sjellë rezultate konkrete për zhvillimin socio-ekonomik dhe avancimin e reformave në



Republikën e Kosovës. Nga ana tjetër, Bjerde falënderoi Bajramin për bashkëpunimin e deritashëm me Qeverinë e Kosovës dhe u shpreh se Banka

Botërore do të jetë partnere e fuqishme e Kosovës. Ajo shtoi se ekipi i Bankës Botërore do të punojë ngushtë me Ministrinë e Financave dhe Qeverinë e

Kosovës për financimin e projekteve dhe reformave që do të kontribuojnë në rimëkëmbjen ekonomike të Republikës së Kosovës.

57 raste të reja me Covid dhe katër të vdekur në Kosovë

Kosovës të premtën i janë shtuar 57 raste të reja me Covid-19, pas marrjes së 678 mostrave. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se brenda 24 orëve janë regjistruar katër viktime, duke e çuar numrin total të të vdekurve me Covid në Kosovë në 611. Sipas të dhënave të këtij Instituti, të premtën janë regjistruar edhe 137 raste që kanë mposhtur virusin, kurse raste aktive aktualisht janë 2 003



shëruar 137 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 12 325 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2 003.

Rastet pozitive janë nga:

komuna Prishtinë 16 raste, komuna Gjilan 6 raste, komuna Pejë 5 raste, komuna Lipjan 4 raste, komuna Deçan 3 raste, komuna Klinë 3 raste, komuna Podujevë 3 raste, komuna Drenas 2 raste, komuna Fushë

Kosovë 2 raste, komuna Mitrovicë 2 raste, komuna Prizren 2 raste, komuna Skenderaj 2 raste, komuna Viti 2 raste, komuna Vushtrri 2 raste dhe me nga një rast komunat Ferizaj, Kamenicë dhe Kaçanik.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 678 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve

rezultojnë 57 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar katër raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv (dy raste nga Klinika Infektive, një rast nga Spitali Rajonal Prizren dhe një rast nga Spitali Rajonal Pejë).

Numri total i rasteve pozitive është 14 939 raste nga 60 913 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 611 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë

Lushtaku: Dialogu dhe zhvillimet me Specialen kanë nevojë për qeveri të qëndrueshme

Kryetari i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Skenderaj, Sami Lushtaku, ka thënë se duhet të bëhen bashkë pozita dhe opozita për temat që e presin vendin. Ai ka thënë se sidomos PDK-ja duhet të marrë përgjegjësi më të mëdha në këtë kohë. Lushtaku ka thënë se dialogu me Serbinë dhe zhvillimet që lidhen me Gjykatën Speciale kanë nevojë për qeveri të qëndrueshme e cila përbëhet nga shumica e kualifikuar, me qëllim që vendimmarrja karshi këtyre sfidave të jetë e lehtë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Kryetari i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Skenderaj, Sami Lushtaku, ka thënë se vendi ynë ka para vetes sfida të mëdha. Ai ka theksuar se menaxhimi i pandemisë Covid-19, dialogu me Serbinë dhe zhvillimet që lidhen me Gjykatën Speciale kanë nevojë për qeveri të qëndrueshme e cila përbëhet nga shumica e kualifikuar, me qëllim që vendimmarrja karshi këtyre sfidave të jetë e lehtë. "Ekonomia dhe qytetarët e Kosovës presin dorën e shtetit në këtë kohë të krizës. Mosvotimi i

ligjeve që mundësojnë tërheqjen e shumës prej 10 për qind nga trusti nuk i është dashur askujt. Edhe mosvotimi i mëhershëm i ligjit për vlerat e luftës ka qenë gabim i rëndë i qeverisë. Pastaj, mosvotimi i një pakoje të gjerë emergjente për inate ndërmjet pozitës dhe opozitës dëmton direkt qytetarin e Kosovës", ka shkruar Lushtaku në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka shtuar se qytetarët dhe ekonomia jonë kanë nevojë për stimuj që sadopak ndihmojnë për ta kaluar sa më lehtë këtë situatë. "Dialogu me Serbinë duhet të marrë epilog. Është tema më e lodhshme dhe më e rënda që prej pasluftës e tutje. Ky dialog duhet të përfundojë me

njohje reciproke, por edhe në këtë proces nevojitet konsensus i plotë pozitiv dhe opozitë. Është qasje e gabuar që kushdo që udhëheq dialogun dhe bën marrëveshje, të kritikohet e të etiketohet si 'tradhtar'. Në vend të kritikave, duhet të bëhet

bashkë pozita dhe opozita, sidomos PDK-ja, e cila duhet të marrë përgjegjësi më të mëdha sepse ka përvojë dhe kapacitete për të qenë pjesë e këtyre proceseve", ka thënë ai. Lushtaku ka pohuar se Kosova ka nevojë për stabilitet politik.

"Nuk na duhen inate dhe protagonizëm. Na duhet qeveri që ruan dhe afirmon miqësinë me ShBA-në. Na duhet qeveri vendimmarrëse që u jep përgjigje meritore këtyre sfidave që i kemi para", ka deklaruar Lushtaku.

Bizneset kërkojnë më shumë përkushtim nga shteti për rritje të eksportit

PRISHTINË, 18 SHTATOR (ER) - Kriteret që duhet t'i plotësojnë bizneset e sektorit të mishit për eksport të produkteve, nevoja për përkrahje nga institucionet, kontrolli i kufirit për ta ndaluar qarkullimin e produkteve në mënyrë jolegale dhe bashkëpunimi i inspektoratit komunal me atë qendror ishin disa prej temave kryesore të diskutimit në takim virtual të realizuar ndërmjet Odës së Afarizmit të Kosovës, drejtorit të Shëndetit Publik në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës (AUVK), Flamur Kadriu dhe bizneset e sektorit të mishit.

Kryetari i Bordit i Odës së Afarizmit të Kosovës, Skënder Krasniqi, ka përgëzuar AUVK-un për arritjen e eksportit të mishit të ardhur nga Evropa me prejardhje nga shpezët. "Ky mish të mundësohet të ketë prejardhje edhe nga Kosova, e jo të jetë obligim prejardhja nga vendet e Bashkimit Evropian apo vendet e lejuara nga BE", ka thënë Krasniqi.

Kadriu ka falënderuar OAK-un dhe bizneset për takimin, duke shtuar që momentalisht është arritur të eksportohet vetëm mish i shpezëve, prejardhja e të cilave është nga BE-ja apo vendet e pranuar nga BE-ja. Për ta arritur këtë, AUVK ka kaluar një proces për tri vjet, ndërsa një nga vështirësitë e hasura ishte mosqartësia e statusit të shëndetit të kafshëve në Kosovë.

Më tutje, sipas Kadriut, Kosova fillimisht duhet t'i kontrollojë kufijtë ashtu që të mos lejohet futja joformale e shtazëve e, gjithashtu, duhet të anëtarësohet edhe në Organizatën për Shëndetin e Kafshëve sepse momentalisht nuk kemi të drejtë t'i raportojmë sëmundjet e kafshëve.

Kadriu ka pohuar se mungesa e bashkëpunimit të Inspektorëve të Veterinarisë në nivel komunal me ata qendrorë po e vështirëson edhe më shumë kontrollin në terren.

Adil Spahiu nga "Industria e



Mishit Malësia" ka theksuar se shteti duhet t'i mbrojtë bizneset prodhuese duke iu lehtësuar qasjen në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare, duke shtuar tutje që bizneset e këtij sektori janë të gatshme ta përkrahin AUVK-un në çdo mënyrë ashtu

që të tejkalohet situata aktuale. Gëzim Selimi nga "Industria e Mishit Calabria" ka kërkuar të informohet në detaje për eksportin e produkteve të mishit të shpezëve, prejardhja e të cilave është nga vendet e BE-së. Bizneset në këtë takim virtual

patën mundësinë të informohen nga afër lidhur me mundësitë e zhvillimit të veprimtarive të tyre, ku në fund të takimit u pajtuan që të zhvillohet edhe një sesion informues me biznesin e parë që ka arritur të eksportoje.

ASK-ja: Bruto Produkti Vendor në vitin 2019 shënoi rritje

PRISHTINË, 18 SHTATOR (ER) - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat e Bruto Produktit Vendor (BPV) për vitin 2019 sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve bazuar në ESA 2010.

Bruto Produkti Vendor me çmime aktuale në vitin 2019 ishte 7 103.8 milionë euro, ndërsa rritja reale në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018 ishte 4.94 për qind.

Ndërkaq, BPV-ja për kokë banori për vitin 2019 ishte 3 986 euro. Rritje reale për vitin 2019 kishte në këto aktivitete ekonomike: aktivitetet financiare dhe të sigurimit (12.1 për qind); administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi i detyrueshëm social (9.2 për qind); bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi (8.0 për qind); furnizimi me energji elektrike dhe me gaz (6.5 për



qind); transporti dhe magazinimi (6.5 për qind); shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale (6.4 për qind);

hotelet dhe restaurantet (6.4 për qind); industria përpunuese (5.3 për qind); tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i

automjeteve dhe motoçikletave (4.3 për qind); ndërtimtaria (3.5 për qind); industria nxjerrëse (3.2 për qind); aktivitetet

profesionale, shkencore dhe teknike (3.1 për qind); edukimi (3.0 për qind); furnizimi me ujë (2.6 për qind); aktivitetet administrative dhe mbështetëse (2.5 për qind); dhe afarizmi me pasuri të patundshme (1.1 për qind).

Ndërsa rënie kishte në art, zbavitje dhe rekreacion (-38.8 për qind).

Rritja reale sipas komponentëve kryesorë të BPV-së me qasjen e shpenzimeve për vitin 2019 ishte te: eksporti i shërbimeve (20.8 për qind); importi i shërbimeve (19.0 për qind); shpenzimet e konsumit final të qeverisë (9.6 për qind); formimi i bruto kapitalit fiks (6.8 për qind); eksporti i mallrave (3.7 për qind); importi i mallrave (2.8 për qind); shpenzimet e konsumit final të IJPSHESH (0.6 për qind); dhe shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake (0.3 për qind).

Kërkohet ndryshimi i ligjit për prokurim publik

PRISHTINË, 18 SHTATOR (ER) - Klubi i Prodhuesve së bashku me STIKK - Shoqatën për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës, KIMERK - Kllasteri i Bizneseve të Industrisë së Metalit dhe Energjisë së Ripërtëritshme të Kosovës, KAMA - Shoqata Kosovare për Marketing të Veshmbathjeve, Shoqata e Përpunuesve të

Drurit të Kosovës dhe G7 - Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës, kërkojnë ndryshimin e ligjit për prokurim publik. Kjo kërkesë vjen kur shumë prodhues vendorë janë duke u përballur me vështirësi të shumta shkaku i pandemisë, për këtë arsye kërkohet ndryshimi i ligjit të prokurimit, në mënyrë që në procedurat e tenderim-

it për produkte dhe shërbime t'u jepet përparësi kompanive vendore. "Kjo kërkesë, për t'u dhënë përparësi kompanive vendore prodhuese apo shërbuese, kërkohet të bëhet përmes ndryshimit të ligjit aktual për prokurim publik apo përmes një vendimi të veçantë qeveritar", thuhet në njoftimin e Klubit të Prodhuesve.



Prodhuesit vendorë kërkojnë favorizime në procedurat tenderuese



FOL: Favorizime të tilla bien ndesh me direktivat e BE-së

Mexhide Demolli-Nimani, drejtoreshë e Lëvizjes FOL, organizatë kjo që pritet të jetë pjesë e grupit punues, thotë se përfshirja e kësaj çështje në ligj do të jetë kundër direktivave të Bashkimit Evropian (BE). "Sa iu përket favorizimeve për prodhuesit, pavarësisht qëllimit të mirë me anë të të cilit edhe do të mund të rritej ekonomia vendore, një gjë e tillë nuk mund të përfshihet në ligj sepse do të ishte kundër direktivave të BE-së. Por, ne si FOL besoj se do të jemi pjesë e grupit punues kur do të fillojë edhe hartimi i ligjit dhe do të shohim si do të rrjedhin gjërat", thotë Demolli.

**Klubi i prodhuesve:
Industria e prodhimit të
shpallet sektor
i rëndësishëm nacional**

Udhëheqës të Klubit të Prodhuesve, në një takim që kanë pasur të mërkurën (16 shtator) me kryetaren e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, kanë paraqitur edhe Rezolutën e prodhimit. Me anë të kësaj rezolute kërkohet që industria e prodhimit të shpallet sektor i rëndësishëm nacional. Në një komunikatë për media u tha se "Klubi kërkon nga Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës që t'i përkrahë ndërmarrjet prodhuese me qëllim të rritjes së kapaciteteve të tyre. Po ashtu, ky klub kërkon nga Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës që rimëkëmbjen ekonomike të vendit ta bazojnë në fuqizimin e industrisë së prodhimit, si zgjidhjen e vetme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Ndryshe pas konfirmimit të rasteve të para me koronavirus në muajin mars, Qeveria e Kosovës vendosi për ndërprerjen e veprimtarisë së disa bizneseve si masë për ta parandaluar përhapjen e koronavirusit të ri që shkakton sëmundjen Covid-19. Pas kësaj, Astrit Panxha nga Klubi i Prodhuesve thotë se industria e prodhimit, konkretisht ajo e përpunimit të ushqimit në Kosovë, ka zvogëluar kapacitetet prodhuese për shkak të rënies së fuqisë blerëse. Për t'i rikuperuar dëmet financiare, prodhuesit vazhdimisht po kërkojnë përkrahje financiare nga qeveria.

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Kompanitë prodhuese në Kosovë po kërkojnë nga autoritetet qeveritare që në procedurat e tenderimit institucionet publike ta fusin si kriter prodhimin vendor si përkrahje për rimëkëmbje ekonomike pas humbjeve të shkaktuara nga pandemia e koronavirusit.

Astrit Panxha, drejtor ekzekutiv në Klubin e Prodhuesve të Kosovës, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" tregon se industria e prodhimit është një nga sektorët që ka pësuar humbje të mëdha nga pandemia. Me qëllim të fuqizimit të kësaj industrie, thotë ai, është kërkuar që në një periudhë trevjeçare të krijohet një bazë ligjore, në mënyrë që në procedurat e tenderimit për mallra dhe shërbime tek institucionet publike, përparësi të kenë operatorët ekonomikë prodhues nga Kosova. "Qeveria është një ndër shpenzueset më të mëdha dhe nëse këtë boshllëk e mbulon qeveria me shpenzimet e veta, atëherë ndikimi në ekonomi do të jetë shumë pozitiv. Nëse një pjesë e këtyre mjeteve shpenzohen

duke i furnizuar, për shembull, burgjet me ushqim apo duke i pajisur shkollat me produkte vendore, atëherë ndikimi do të jetë shumë pozitiv për mbrojtjen e vendeve të punës dhe krijimin e vendeve të reja të tyre", thekson Panxha.

Nga Thesari i Kosovës bëjnë të ditur se për periudhën janar-qershor të këtij viti për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 110 milionë euro, duke shënuar ulje prej 3.1 përqindësh, kurse në vitin 2019 për këtë kategori janë shpenzuar 273 milionë euro.

Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve hyjnë furnizimet me artikuj të nevojshëm për objekteve të ndryshme publike, shërbime dhe telekomunikacionit dhe shumë shpenzime të tjera.

Krasniqi: Në tenderë të përkrahen operatorët ekonomikë nga Kosova

Pas kërkesës së Klubit të Prodhuesve, ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ditë më parë, nëpërmjet një

ftese publike, ka kërkuar nga institucionet publike dhe shtetërore të vendit të gjejnë forma që gjatë tenderimit t'i mbështesin prodhimet vendore. Ministri Krasniqi thotë për "Radion Evropa e Lirë" se shumë nga institucionet e publike, gjatë furnizimit me produkte të ndryshme, blejnë mallra me origjinë nga shtete të tjera kurse, sipas tij, produkte të ngjashme mund të gjenden edhe në tregun e Kosovës me çmime më të lirë. "Procedurat e prokurimit nuk e lejojnë një gjë të tillë, mirëpo për shkak të pandemisë e cila po mbizotëron edhe në vendin tonë, ne mund të kërkojmë që me ndonjë kriter të veçantë, gjatë procedurave të organizatave buxhetore, përparësi t'u jepet prodhimeve vendore", tha Krasniqi.

Në Ligjin e prokurimit publik, që rregullon këtë fushë, e që është miratuar në vitin 2011 nga Kuvendi i Kosovës, thuhet se "autoriteti kontraktues do t'ia japë kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët", pa përmendur origjinën e mallit.

Kabashi: Përkrahja e prodhimeve vendore duhet të rregullohet me ligj

Jetullah Kabashi, eksperti i prokurimit në Departamentin e Rregullave në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik të Kosovës, thotë se mundësia për një favorizim eventuale të kompanive vendore mund të ekzistojë, por për këtë kërkohet bazë ligjore. "Por, kjo e kërkon një bazë ligjore, të argumentuar dhe për mua është shumë e arsyeshme dhe e nevojshme që të përkrahen prodhimet vendore", tha Kabashi. "Tash do të formohet një komision prej disa anëtarësh që do ta përpunojë ligjin (e prokurimit publik) dhe është mirë që këtë çështje të fusin në kuadër të ligjit", shtoi ai.

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 10 shtator ka aprovuar koncept-dokumentin për fushën e prokurimit publik, në bazë të të cilit do të fillojë puna për hartimin një ligji të ri.

Stabiliteti energjetik, parakusht për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Kosovës

PRISHTINË, 18 SHTATOR (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të premtën në takim bordin e KOSTT-it, i kryesuar nga kryesuesi i bordit Jeton Mehmeti si dhe kryeshefin ekzekutiv, Ilir

Shala, me të cilët ka biseduar për zhvillimet e përgjithshme në sektorin e energjisë, stabilitetin energjetik në vend. Me këtë rast, kryeministri Hoti ka ofruar mbështetjen e Qeverisë së Kosovës, duke

thënë se stabiliteti energjetik është parakusht për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit, i rritjes së investimeve të brendshme dhe atyre të jashtme dhe në funksion të mirëqenies së qytetarëve.



E jashtëzakonshme

Shtëpia më e çuditshme në botë



E vendosur rrëzë malit në Portugalinë Veriore, Casa do Penedo mund të rradhitet ndër objektet më të çuditshme në botë. Kjo shtëpi, e ndërtuar në vitin

1974, perfekt përshtatet në peizazhin malor falë idesë së pazakonshme të ndërtuesit që shtëpinë ta vendosë në katër shkëmbinj. Shtëpia është quaj-

tur me emrin e përshtatshëm "Shtëpia nga guri" (Casa do Penedo), ajo në mënyrë të përsosur bashkon pjesët e natyrës me njeriun.

BARSOLETA E DITËS



Një njeri e kishte dërguar televizorin te mjeshtri për ta riparuar.

- Çfarë ka televizori?, e pyet mjeshtri.
- S' di për nder, isha duke e kruar veshin me gjilpërë kur, papritmas, iu ndal zëri televizorit.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje



FOTO E DITES



Bukuri të filmuara nga lart të Liqenit të Ujmanit

E rrallë

Akuariumi mbledh 400 litra monedha të hedhura në ujëvarë nga vizitorët në Karolinën e Veriut

Me shtrëngimin financiar të kohëve të koronavirusit, akuariumi Pine Knoll Shores në Karolinën e Veriut në ShBA ka vendosur të mbledhë me kova monedhat e hedhura "për fat" në pusin e tij nga vizitorët. Vendi duhet t'i mbajë kafshët të shëndetshme e të ushqyera, si dhe t'i paguajë rrogat e stafit në një kohë kur vizitorët janë reduktuar së tepërmi prej pandemisë.



DASHI
Ditën e sotme me siguri do të përplaseni me një ose më shumë anëtarë të familjes, ndoshta për çështje që lidhen me paratë.



DEMI
Ndjenjat dhe dashuria janë në krye të listës suaj të interesave. Do të dashuroheni me një person me shikim të parë.



BINJAKËT
Edhe nëse do t'ju kushtojë, mermi parasysh me kujdes shpenzimet dhe të ardhurat tuaja në mënyrë që të mos keni ndonjë surprizë më vonë.



GAFORRJA
Sot do të zbuloni se një qëndrim më i qëndrueshëm do t'ju japë më shumë besueshmëri të tjerët.



LUANI
Diçka pozitive do të ndodhë tek angazhimet tuaja, të cilat janë gjithnjë e më të ngutshme dhe të shumta.



VIRGJËRESHA
Mendja juaj do të jetë vigjilente dhe do të vini re detaje të rëndësishme që keni humbur deri më tani.



PESHORJA
Projektet dhe synimet kthehen në një drejtim, por vendimet dhe vullneti i të tjerëve ndërhyjnë për t'i ndryshuar kartat në tryezë.



AKREPI
Kënaqësitë dhe sukseset do të bien mbi ju, pa bërë shumë sakrificat! As sektori sentimental nuk është i keq.



SHIGJETARI
Nuk do të mungojnë mundësitë për rekreacion dhe argëtim, për të jetuar marrëdhënie romantike me më shumë entuziazëm dhe qetësi.



BRICJAPI
Kushtojuni vëmendje goditjeve që iu vijnë nga kolegët tuaj. Ato mund t'ju penalizojnë vetëm me disa fjalë të ftohta.



UJORI
Është koha për të vendosur rregull rreth jush dhe për të zgjidhur disa çështje praktike të cilat për disa kohë kanë qenë një arsye për diskutim me partnerin tuaj dhe familjen tuaj.



PESHQIT
Ju keni një frymë të jashtëzakonshme initiative në anën tuaj, aq sa puna do të marrë një rëndësi të veçantë.

Dua Lipa mahnit me dukjen plot shkëlqim në “The Late Late Show”



Ajo ka shijuar disa ditë të mira pushimi në Los Anxhelos gjatë javëve të fundit, pasi u largua nga Britania e Madhe për të kaluar kohë me të dashurin e saj Anwar Hadid në shtetin e tij të lindjes. Dhe Dua Lipa u takua me një tjetër britanik me bazë në ShBA të

enjtën, kur ajo bëri një paraqitje në “The Late Late Show” të James Corden, shkruan “DailyMail”. Këngëtarja 25-vjeçare ndau me ndjekësit në “Instagram” disa pamje të vetes ku shfaqej me një fustan vezullues derisa tregonte linjat atraktive trupore.



Bluza shumë e shkurtër e ‘tradhton’ Kinsey Wolanskin

Kinsey Wolanski vazhdon të publikojë çaste nga përditshmëria e saj, duke i informuar ndjekësit në rrjetet sociale për çdo të re

rreth saj. Së fundi, ajo pozoi e veshur me një fustan dhe bluzë tejet të shkurtër, në të cilën tregonte më shumë sesa që duhej.

Bebe Rexha nuk fshihet më, publikon foto në çaste romantike me të dashurin



Bebe Rexha është një prej atyre fytyrave publike që çdoherë tenton ta mbajë larg vëmendjes së publikut jetën


private. Së fundi, ajo publikoi një fotografi në të cilën shfaqet pranë të dashurit, por edhe këtë herë ia mbuloi fytyrën atij.

Ava Max publikon albumin e parë debutues “Heaven and Hell”



Artistja shqiptare me renome botërore, Ava Max, ka bërë një tjetër ngjitje të suksesshme në karrierë. Më në fund, pas dy vjetësh debutim në tregun ndërkombëtar dhe një pune intensive përgjatë kësaj kohe, ajo ka arritur të nxjerrë në treg albumin e saj të parë. “Heaven and Hell” titullohet albumi i parë debutues i

këngëtares shqiptare që, përkthyer në shqip, do të thotë “Parajsa dhe ferri”. E lumtur për këtë projekt të saj, Ava Max, ndau me ndjekësit në rrjetin social “Instagram” lajmin se tashmë albumi i saj i parë është i disponueshëm në të gjitha platformat online dhe si kopje fizike në dyqane.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Ndarje emocionuese e Musollit me Kukësin, e ardhmja është Gjilani

Futbollisti Besar Musolli është larguar nga Kukësi pas tetë vjetësh qëndrim. Lamtumira e tij nga skuadra shqiptare ka qenë mjaft emocionuese, kurse fanellën e Kukësit e ka quajtur si lëkurën e dytë. E ardhmja e mesfushorit me përvojë të madhe do të jetë skuadra e Gjilanit në Kosovë



punuar, por edhe drejtuesit në krye me presidentin Safet Gjici. "Largohem nga Kukësi me respektin maksimal, duke lënë pas vetes një histori që është shkruar me germa të arta e nuk mund ta përshkruaj me fjalë gjithë emocionin që kam ndier. Largohem nga kampionati shqiptar për të qenë pranë familjes e për t'iu dedikuar fëmijëve të mi. Në fund, me përlësi dua ta falënderoj çdo tifoz të Kukësit, i cili përgjatë rrugëtimit tim më ka bërë të ndihem i vlerësuar në çdo minutë. Ju jeni dhe do të mbeteni gjithnjë në zemrën time jo si tifozët e mi, por si miqtë e mi dhe ata që më keni qëndruar pranë. Ka ardhur momenti për të thënë lamtumirë, ama Kukësi do të jetë gjithnjë pjesë e jetës sime, si epoka më e artë e karrierës sime", ka përfunduar Musolli, i cili karrierën futbollistike pritet ta vazhdojë në skuadrën e Gjilanit në IPKO Superligën e Kosovës në futboll.

përveç falënderimeve. Kur kam ardhur në verën e vitit 2012 nuk e kisha menduar se kjo fanellë do të më kthehej në një lëkurë të dytë. Nëse do të përmend emra do të jetë e vështirë, për të mos

thënë e pamundur për t'i përmendur të gjithë e nuk dua ta harroj askënd", ka shtuar ai. Ish-reprezentuesi i Kosovës ka falënderuar çdo lojtar dhe pjesëtar stafi me të cilët ka

momenti që rrugëtimit me Kukësin dhe Superiore të mbyll këtu. Jam i lumtur që në tetë vjet te Kukësi kam arritur të fitoj gjithçka, të derdh lot gëzimi, të ngre trofe dhe ta shkruaj historinë në Evropë e, mbi të gjitha, të mbaj në krah shiritin e kapitenit, i cili për mua peshon shumë", ka thënë Musolli, i cili ndihet i lumtur dhe krenar që në çdo stadium ku ka shkelur ka gjetur mikpritje.

Ai ka shkruar edhe më larg, duke thënë se fanella e Kukësit i është kthyer në një lëkurë të dytë. "Nuk kam asnjë fjalë tjetër

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 SHTATOR - Ndeshja e Ligës së Evropës kundër Wolfsburgut ishte e fundit për mesfushorin Besar Musolli në fanellën e Kukësit. Futbollisti nga Kosova ndahet me skuadrën shqiptare pas tetë vjetësh qëndrim, kurse sukseset gjatë kësaj kohe kanë qenë të panumërta. Lajmin e ka konfirmuar vetë Musolli nëpërmjet një postimi në profilin e vet në "Facebook". "Çdo fillim e ka edhe një fund dhe për mua ka ardhur

FIBA: Ndeshjet e nëntorit dhe shkurtit zhvillohen në një kompleks



PRISHTINË, 18 SHTATOR - FIBA ka publikuar një deklaratë në lidhje me ndeshjet e nëntorit 2020 dhe shkurtit 2021. Duke pasur parasysh shëndetin dhe sigurinë e lojtarëve, trajnerëve dhe stafit në vend të parë, dhe pas një rekomandimi nga Komisioni Mjekësor dhe Komisioni i Garave, Komiteti Ekzekutiv i FIBA-s ka vendosur në lidhje me kualifikuesit e nëntorit 2020 dhe shkurtit 2021 për Kupat Kontinentale: "Të gjitha ndeshjet e të dy dritareve duhet të zhvillohen në një 'kompleks', ku do të izolojnë në një vend nga pjesa tjetër e popullsisë, në vend

të vendas/mysafirë, me marrëveshjen e autoriteteve të shëndetit publik pritës dhe në përputhje me protokollet shëndetësore të FIBA-s (përfshirë testimin e PCR dhe hyrjen e kontrolluar në një mjedis të sigurt në qytetin pritës). Çdo 'kompleks' do të përbëhet nga 4 ose 8 ekipe (një ose dy grupe kualifikimi). Pritësit do të vendosen në nivelin rajonal dhe do të shpallen në kohën e duhur". FIBA do të vazhdojë ta monitorojë situatën me Covid-19 për çdo ditë dhe të komunikojë azhurnime të

mëtejshme në lidhje me garat e FIBA-s kur është e nevojshme. Në raundin e parë të para-kualifikimeve për FIBA Kupën e Botës 2023, Kosova është në Grupin B, së bashku me Islandën, Sllovakinë dhe Luksemburgun. "Dardanët" në dy ndeshje kanë shënuar dy fitore, duke mundur Islandën dhe Luksemburgun në shtëpi, kurse në nëntor të këtij viti ishin planifikuar dy ndeshjet në udhëtim ndaj Sllovakisë dhe Islandës, ndërsa në shkurt të vitit të ardhshëm, dy përballjet e fundit në Prishtinë kundër Sllovakisë dhe Luksemburgut.

Drita deri tash ka fituar 1 milion e 30 mijë euro

GJILAN, 18 SHTATOR - Kampionia e Kosovës në futboll, Drita, e siguroi kualifikimin në fazën e tretë kualifikuese të Ligës së Evropës. Pas këtij suksesi historik për futbollin e Kosovës, klubi gjilanas ka përfituar një shumë të majme nga UEFA. Drita do të marrë 260 mijë euro nga UEFA për faktin se është shpallur kampione e Kosovës, kurse për pjesëmarrjen

në fazën preliminare të Ligës së Kampionëve, gjilanasit do të fitojnë 230 mijë euro. Pas humbjes në tavolinë ndaj Linfieldit, bardhekaltrit përfunduan në raundin e dytë të Ligës së Evropës, ku skuadrat që luajnë në këtë rreth marrin 260 mijë euro. Pas fitores ndaj Sileksit (0-2), Drita u kualifikua në raundin e tretë kualifikues të

Ligës së Evropës, duke përfituar edhe 280 mijë euro për kalimin në këtë rreth. Gjilanasit kanë fituar deri më tash 1 milion e 30 mijë euro nga shtëpia drejtuese e futbollit evropian. Klubi nga Gjilani është shpërblyer me 30 mijë euro edhe nga Federata e Futbollit e Kosovës për fitimin e titullit kampion në edicionin që lamë pas.



Mourinho: Nuk di asgjë për Shkëndijën

LONDËR, 18 SHTATOR - Shkëndija e Tetovës në raundin e tretë të Ligës së Evropës do të përballet me skuadrën Tottenham Hotspur. "Spurs"-at e


eliminuan Lokomotiv Plovdivin. Trajneri i Tottenham Hotspurit, Jose Mourinho, ka thënë se nuk di asgjë për skuadrën shqiptare nga Tetova. "Nuk di asgjë për

Shkëndijën. As nuk dija për Lokomotiv Plovdivin. Tani kemi përpara ndeshjen në Angli dhe më pas do të nisim të përgatisim përballjen për në Maqedoninë e Veriut. Ajo

që di me siguri është se do të jetë shumë e vështirë. Në turet me tek ndeshje, është e vështirë, pasi luhet gjithçka në 90 minuta", ka thënë Mourinho.



Rrëfim nga Elinda Musliu: Idhulli i fëmijërisë, ndeshja e paharrueshme dhe trofeu më i veçantë



PRISHTINË, 18 SHTATOR - Një nga lojtarët më të dalluara në basketbollin e femrave ishte Elinda Musliu. Ish-basketbollistja e Bashkimit në një intervistë për faqen zyrtare të FBK-së ka folur se si e filloi basketbollin, se kush ishte idhulli i saj në fëmijëri, për ndeshjen e paharrueshme, për kundërshtaren më të vështirë, për nostalgjinë për basketboll dhe ka dhënë një mesazh për vashat e reja.

Si vendose të luaje basketboll?
Me basketboll fillova të luaj në shkollë fillore, konkretisht në garat e sportit shkollor dhe prej atëherë basketbolli ka qenë

sporti të cilin vendosa të vazhdoj e të merrem me shumë dëshirë.

Cili ka qenë idhulli yt në fëmijëri?

Idhulli im që në fëmijëri ka qenë Allen Iverson pasi që luante në pozitën e organizatorit, pozitë kjo që edhe unë e kam luajtur në lojën e basketbollit.

Cili ka qenë trofeu më i rëndësishëm për ty dhe pse?

Trofeu më i rëndësishëm ka qenë në Karagaç të Pejës. Ishte një finale e paharrueshme. E veçoj këtë finale pasi që titulli i dedikohet në atë kohë të ndjerit, Isuf Lumit. Nuk i përjashtoj

edhe trofetë e tjerë sepse secili në vete ngërthen një kuptim të bukur dhe plot emocione.

Cilën ndeshje nuk mund ta harrosh asnjëherë?

Finalja në vitin 2005 e mbajtur në Therandë, ku jemi ballafaquar me Ish-Universitetin atë kohë dhe pas shumë viteve arritëm ta kthejmë titullin e kampionit në Prizren.

Cila ka qenë kundërshtarja më e vështirë që je ballafaquar?

Kundërshtarë të përhershëm e kemi pasur Universitetin. Ndërsa në aspektin individual nuk kam pasur asnjëherë kundërshtarë të vështirë sepse

kam besuar në lojën time dhe vetëbesimi im ka qenë i plotë, gjë që shumë herë ka bërë të tregoj rezultate të larta të vlerësuara nga profesionistët e basketbollit.

Sa të mungon basketbolli dhe atmosfera nga koha kur ke luajtur?

Basketbolli më mungon shumë nga ajo kohë sepse ishim generatë e artë përveç që ishim basketbolliste, bashkëlojtare apo kundërshtarë në mes vete kishim edhe miqësi që e veçonim shumë. Mendoj që loja e basketbollit atë kohë kishte kuptim tjetër karshi kësaj që sot e shohim sepse neve kishim

dëshirë dhe dashuri pa interes për basketbollin. Asnjëherë nuk e kemi pasur prioritet interesin material për dallim nga sot, që shoh më shumë interes material se sa profesionalizëm apo dëshirë dhe dashuri të pastër ndaj basketbollit.

Cili është mesazhi për lojtarët e reja që duan të merren me basketboll?

Mesazhi për basketbollistet e reja është që të punojnë shumë për të arritur ndoshta pak. Asnjëherë mos të dorëzohen para sfidave që iu dalin përpara, por ta duan lojën e basketbollit dhe të shkojnë drejt synimeve që kanë.


Miami fiton edhe finalen e dytë ndaj Bostonit

ORLANDO, 18 SHTATOR - Miami ka fituar me rezultat 106-101 ndaj Bostonit në ndeshjen e dytë të "play-off"-it në Konferencën e Lindjes, duke udhëhequr 2-0 serinë e ndeshjeve. Edhe kjo sfidë,

ashtu si e para, ishte me rivalitet dhe emocione deri në fund. Miami arriti të triumfojë në dy minutat e fundit, ku pas barazimit 95-95 u tregua më e saktë në gjuajtje. Gjashtë lojtarë të Miamit

realizuan mbi 11 pikë, përfshirë pesë titullarët. Shënuesi më i mirë për Miamin ishte Dragiq me 25 pikë, mbështetur nga Adebayo me 21 pikë e 10 rebounde. Për Bostonin u dalluan Walker me 23

pikë e Tatum me 21, por që mbetën për statistikë. Sot (e shtunë) nisin finalen e "play-off"-it në Konferencën e Perëndimit, ku përballë njëri-tjetrit janë Lakersat dhe Denveri.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES
 AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
 AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA
 ODRASLE
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 236/1
 Dt: 18.09.2020

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

SHPLLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendra e Kompetencës në Skenderaj për vitin shkollor 2020/2021

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Skenderaj	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Matematikës me 10 orë mësimore;	Vend i lirë
			Një (1) mësimdhënës/e për Gjuhë angleze me 10 orë mësimore;	Vend i lirë
			Një (1) mësimdhënës për profilin Instalues të ngrohjes, ventilimit/kondicionimit të ajrit 20 orë mësimore	Zëvendësim

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgatitjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatitje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPLLJE TË VOGLA <<

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

► Eulona Hasani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. Njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë të shkollës "Ahmet Gashi" Prishtinë.

► "Deholz Industry" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811350446.

► "Beksal Global" SH.PK shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810181842.

► Erdon Koqinaj nga Prizreni, shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit të Arkitekturës të UP-së, të lëshuar në vitin 2012.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



Kompania Regjionale e Mbeturinave
"Ambienti" Sh.A me adresë : Rr.Xhem Sadrija P.n Pejë
Data 19.09.2020

Bazuar ne ligjin e Punës Nr.03/L-212 të dt. 02.11.2010, neni 8 dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 07 / 2017. Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A .Pejë publikon këtë :

KONKURS

Për plotësimin e vendeve te lira te punës pozitat:

Pozita: (1) Inspektorë të Brendshëm - Vendi i punës - Klinë.

Inspekton terrenin se a është bere dorëzimi i faturave te konsumatorët.
Inspekton terrenin se a është bere përditësimi i te dhënave për konsumatorët, siguron qe borxhi i konsumatorëve te precizohet, dhe te mos bartet nga një person tek tjetri pa e rregulluar borxhin e mëparshëm. Bene inspektimin, monitorimin dhe rishikimin e aktiviteve te inkasantëve.
Regjistron ne programin e ndërmarrjes konsumatorët si, emrin, emrin e prindit, numrin personal te konsumatorit dhe te dhënat për biznes sipas certifikatës se biznesit, këto shënime pranohen nga inkasantë, dhe te kontrollohen nga inspektorat se a janë plotësuar kushtet për regjistrim.
Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shërbime me te mire për konsumatorët.
Ne baze te konstatimit te gjendjes reale, dhe te gjeturave ne teren, raporton tek mbikëqyrësi i tij.
Punon planet dhe raportet ditore, mujore, dhe vjetore te punës. Kontrollon dhe verifikon rekapitullimin e shpenzimeve dhe pagesës sipas regjioneve ne aspektin financiar.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkua:

- Shkolla e Mesme e preferuar Diplomë universitare
- Njohja e punës me kompjuter
- Të ketë përvojë pune
- Aftësi të mirë komunikimi

Kandidatët e interesuar duhet ti sjellin këto dokumente për aplikim

Shkolla e Mesme / Diplomën universitare

Biografinë (CV) e detajuar

Letër motivimin

Certifikatën që nuk është nënë hetime

Pozita: Dy (2) Inkasant

Detyrat dhe përgjegjësit:

Bënë inkasimin nga shfrytëzuesit e shërbimeve dhe ngarkohet materialisht me fatura sipas rrugëve dhe reoneve. Për çdo ditë dorëzon pazarin ditor dhe ngarkohet me fatura. Plotëson fletë dorëzimin mbi kryerjen e pagesave me shënimet e duhura. Përcjell gjendjen në teren për zbulimin e sipërfaqeve në sektorin private dhe bënë evidencën e tyre dhe me shkrim e informon shefin e shërbimit. Është i obliguar që të përcjellë ndërrimin e pronarit të banesave, shtëpive dhe të merr shënimet të cilat i dorëzojnë shërbimit komercialo-financiar. Është i obliguar që për çdo parregullsi në fatura, t'i kthejë në rilllogaritje. Obligohet që në teren të sillt korrekt dhe të mban uniform apo shenjë identifikimi të Ndërmarrjes. Kryen edhe punë tjera me urdhëresë të Shefit të inkasimit.
Për punën e vetë i përgjigjet drejtpërdrejt Shefit të Inkasimit.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkua:

- Shkolla e Mesme / Diplomë universitare
- Njohja e punës me kompjuter
- 1 vite përvojë pune
- Aftësia e komunikimit

Dokumentacioni i kërkuar :

Shkolla e Mesme / Diplomë universitare

Biografinë (CV) e detajuar

Letër motivimin

Deklaratën nën betim

Certifikatën që nuk është nën hetime

Pozita : (1) Shef i Sigurim

Detyrat dhe përgjegjësit:

Udhëheq dhe organizon mbrojtjen e të gjitha objekteve dhe pasurisë së Ndërmarrjes.
Bënë mbikëqyrjen dhe kontrollin e punës të shërbimit të sigurimit dhe librave të ndërrimit të punëtorëve të sigurimit. Kujdeset për rregullsinë e mjeteve për mbrojtjen në punë dhe mbrojtjen kundër zjarrit dhe mban evidence lidhur me to. Kontrollon shpenzimet e automjeteve dhe disiplinës së punëtorëve në punë, si dhe paraqet fletëparaqitjen për shkeljen e obligimeve në punë nga ana e punëtorëve si dhe evidenton rastet e lëndimeve në punë. Kryen edhe punë tjera me urdhëresë të Sekretarit Kryeshefit Ekzekutiv. Për punën e vetë i përgjigjet drejtpërdrejt Sekretarit.
Drejtpërdrejt kontakton me organet e Policisë nga fushë veprimtaria e vet.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkua

- Përgatitjen e mesme shkollore përparësi universitare
- 1 vite përvojë pune.
- Përparësi janë certifikimet në siguri.
- Aftësi shumë të mira organizative
- Njohja e punës me kompjuter.
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë

Kandidatët e interesuar duhet ti sjellin këto dokumente për aplikim

Diplomën universitare

Biografinë (CV) e detajuar

Letër motivimin
Deklaratën nën betim
Certifikatën që nuk është nën hetime

Pozita : (1) Punëtor Sigurimi

Detyrat dhe përgjegjësit:

Bënë sigurimin e objektit në të cilin është përcaktuar në bazë të planit mujor.
Bënë shikimin e gjendjes së objektit dhe mjeteve kundër zjarrit dhe rregullsisë së tyre.
Vigjilon dhe largon personat e paautorizuar dhe të dyshimta që ndodhen afër objektit
Ndërmerr masat e nevojshme në mbrojtjen e objektit nga dukurit natyrore dhe për këtë lajmëron menjëherë shërbimet e specializuara. Pranon dhe dorëzon ndërrimin dhe për gjendjen e objektit e informon punëtorin e sigurimit të radhës .Obligohet që në vendin e punës të mbajë uniformën.
Pas orarit të rregullt të punës nuk guxon t'i lejoj hyrjen e personave të paautorizuar, përveç zyrtarëve të lartë të Ndërmarrjes.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkua

Përgatitjen e mesme shkollore

Përparësi janë certifikimet në siguri

Aftësi shumë të mira organizative

Njohja e punës me kompjuter.

Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;

Kandidatët e interesuar duhet ti sjellin keto dokumente për aplikim


- Diplomën universitare
- Biografinë (CV) e detajuar
- Letër motivimin
- Deklaratën nën betim
- Certifikatën që nuk është nën hetime

Informata të përgjithshme:


- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 19.09.2020 deri 03.10.2020

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabartë punësimi ,inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve , pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe gjinive të ndryshme .

-Mënyra e Aplikimit : Aplikacioni merret në ndërmarrje Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A me adresë : Rr.Xhem Sadrija P.n Pejë, Dokumentacioni duhet të dorëzohet në pliko të mbyllura në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon .Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pa vlefshëm. Dokumentet duhet të dozohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk ju kthehen. Dokumentet origjinale mund të kërkohen , sipas nevojës .



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragas/Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



13/537
18.09.2020

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

KONKURS- plotësues

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për arsimin parafillor, fillor të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2020/2021.

SHFMU " Sezai Surroi"- Bellobrad

1. Një mësimdhënësi për mësim klasor në Zym (deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në DKA ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.);
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës);
- Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj;
- Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës , duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).



Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmërisht më datë 01.09.2020, por në varësi të lirimit real të vendit të punës në IEAA (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.).

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Vërejtje: Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Datë: 18.09.2020
Dragash

Drejtori i DKA-së
MSc: Vloran Cenaj



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC COLA
Columbus, Georgia, USA
Since 1905